



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri

**FJALA E KRYETARIT TË PREZENCËS, AMBASADORIT MICHEL TARRAN,
NË FORUMIN E DHJETË PËR ZHVILLIMIN E MEDIAS**

23 tetor 2024

Të nderuar deputetë, z. Ambasador, të dashur kolegë, zonja dhe zotërinj,

- Kam kënaqësinë t'ju mirëpres në Forumin e 10-të të OSBE-së për Zhvillimin e Medias. Gjatë dekadës së fundit, Forumi ka shërbyer si një platformë e rëndësishme për dialog të hapur ndërmjet komunitetit mediatic të Shqipërisë, institucioneve publike dhe partnerëve ndërkombëtarë. Ky takim i sotëm pasqyron angazhimin tonë të vazhdueshëm për të çuar përpara lirinë dhe zhvillimin e medias në Shqipëri.
- Ndonëse liria e shprehjes garantohet nga Kushtetuta e Shqipërisë, gazetaria e pavarur përballet me disa sfida. Lidhjet e ngushta midis biznesit, politikës dhe pronësisë së medias ndikojnë në diversitetin dhe pavarësinë e mediave. Shumë gazetarë përballen me pasiguri në punë, paga të ulëta dhe, në disa raste, fatkeqësisht, me kërcënime dhe frikësime. Indeksi i vitit 2023 i Reporterëve pa Kufij thekson se konfliktet e interesit dhe sfidat ligjore mbeten pengesat kryesore për lirinë e medias në Shqipëri.
- Prezenca e OSBE-së në Shqipëri prej kohësh mbështet përpjekjet për forcimin e kuadrit ligjor dhe institucional që garanton pavarësinë dhe profesionalizmin e medias. Partneriteti ynë me Autoritetin e Mediave Audiovizive ka sjellë përpjekje të rëndësishme, përfshirë zhvillimin e kodeve të transmetimit që promovojnë barazinë gjinore, luftojnë diskriminimin dhe trajtojnë gjuhën e urrejtjes. Kjo është pjesë e një përpjekjeje më të gjerë për të harmonizuar rregulloret e medias në Shqipëri me angazhimet e OSBE-së dhe standardet përkatëse ndërkombëtare dhe evropiane.
- Përveç këtyre reformave ligjore, forumi i sotëm do të trajtojë një sërë çështjesh urgjente, si kapja e medias dhe ndikimi i saj në pavarësinë editoriale. Do të diskutojmë, gjithashtu, sigurinë e gazetarëve, veçanërisht përballë rritjes së numrit të padive dhe kërcënimeve ndaj tyre. Përdorimi i gabuar i kuadrit ligjor, siç janë Paditë Strategjike Kundër Pjesëmarrjes Publike (SLAPP), për të heshtur zërat kritikë, është një prirje që duhet ta kuptojmë të gjithë së bashku, të diskutojmë pasojat e saj dhe të ndihmojmë gazetarët dhe të tjerët për ta luftuar.
- Fokus kryesor i këtij forumi është pronësia e medias, veçanërisht përqendrimi i pronësisë, çka minon pavarësinë e përmbajtjes editoriale. Gazetaria e pavarur është themeli i demokracisë dhe ne duhet të vazhdojmë të avokojmë për transparencë në pronësinë e medias për të siguruar që të dëgjohen të gjithë zërat. Këto sfida nuk janë unike vetëm për Shqipërinë, prandaj do të kemi mundësinë të dëgjojmë edhe këndvështrimet e ekspertëve ndërkombëtarë nga vende të tjera që marrin pjesë në këtë forum.
- Ndërsa u kushtojmë rëndësi sfidave strukturore dhe ligjore me të cilat përballet media në Shqipëri, është po aq e rëndësishme të mos harrojmë përgjegjësinë e vetë gazetarëve

për të ruajtur profesionalizmin, paanësinë dhe objektivitetin në raportimet e tyre. Gazetarët kanë detyrimin ndaj publikut për të ofruar informacion të saktë, të balancuar dhe të bazuar në fakte. Në epokën e dezinformimit dhe sensacionalizmit, roli i tyre në mbrojtjen e së vërtetës është jetik. Respektimi i etikës profesionale, verifikimi i burimeve dhe rezistenca ndaj presioneve të jashtme janë thelbësore për të siguruar që gazetaria të mbetet një shtyllë e palëkundur dhe e besueshme e demokracisë.

- Prezenca e OSBE-së ka mbështetur në mënyrë aktive përpjekjet për reforma në Shqipëri, duke kontribuar në hartimin e udhërrëfyesve për sundimin e ligjit dhe funksionimin e institucioneve demokratike, ku përvijohen reforma për forcimin e lirisë së shprehjes dhe institucioneve demokratike. Këta udhërrëfyes shërbejnë si instrumente të rëndësishme për të udhëhequr reformat e ardhshme në media, dhe diskutimet e sotme do të ndihmojnë në përpunimin e mëtejshëm të këtyre përpjekjeve.
- Në përputhje me rekomandimet e Raportit të Misionit të Vëzhgimit të Zgjedhjeve të ODIHR-it, të majit 2023, duhet të njohim, gjithashtu, rolin që media luan gjatë periudhave zgjedhore, si do të jetë viti i ardhshëm 2025. Përdorimi i materialeve të prodhuara nga partitë politike ose autoritetet shtetërore, në programet e lajmeve dhe të informimit, duhet të shmanget, ose, më së paku, të kufizohet në raste të jashtëzakonshme, veçanërisht gjatë fushatave zgjedhore. Kur transmetohet një material i tillë, është thelbësore që ai të identifikohet qartë si përmbajtje e prodhuar nga garuesit politikë, siç kërkohet nga ligji. Zbatimi i sanksioneve për shkeljet e këtyre kërkesave për identifikim do të sigurojë më tej transparencë dhe do të parandalojë ndikimin e padrejtë mbi median.
- Duhet, gjithashtu, të fokusohemi në forcimin e rolit të gjyqësorit në garantimin e lirisë së shtypit. Sot do të shqyrtojmë mënyrat për përmirësimin e bashkëpunimit ndërmjet gazetarëve dhe gjykatave, duke mundësuar raportim më të saktë dhe transparent për proceset gjyqësore. Kjo është thelbësore në një mjedis mediatik ku shpesh kufizohet qasja në informacion.
- Duke u mbështetur në diskutimet e vitit të kaluar, Prezenca e OSBE-së është e gatshme dhe mbetet e angazhuar për të mbështetur dialogun e strukturuar ndërmjet institucioneve shqiptare dhe sektorit të medias. Për këtë qëllim, ne do të përdorim jo vetëm burimet që kemi në dispozicion si Prezencë e OSBE-në në Shqipëri, por edhe më gjerë, nga institucionet e OSBE-së të specializuara për demokratizimin dhe çështjet e medias. Besojmë se ky dialog do të krijojë një mjedis më bashkëpunues, ku zyrtarët publikë dhe profesionistët e medias mund të punojnë së bashku për të forcuar lirinë e shtypit dhe për të gjetur zgjidhje të përshtatshme për kontekstin shqiptar.
- Për më tepër, synojmë të kontribuojmë në nismën e propozuar në edicionin e vitit të kaluar të Forumit për Zhvillimin e Mediave, duke theksuar rëndësinë e krijimit të një platforme që mundëson dialogun e strukturuar midis qeverisë shqiptare dhe mediave për temat kyçe që lidhen me mediat dhe lirinë e shprehjes. Diskutimet e fundit me partnerët tanë ndërkombëtarë, Delegacionin e Bashkimit Evropian në Shqipëri dhe Këshillin e Evropës janë të drejtuara në angazhimin e përbashkët për të çuar përpara këtë nismë të mbështetur nga qeveria dhe të udhëhequr nga aktorë vendas.

- Krahas reflektimit mbi përparimin e bërë gjatë 10 viteve të fundit, duhet njëkohësisht të shohim edhe drejt së ardhmes. Diskutimet që do të kemi sot do të udhëheqin hapat e ardhshëm në krijimin e një peizazhi mediatik që i shërben interesit publik, mbron integritetin gazetaresk dhe nxit një shoqëri të informuar dhe të angazhuar.
- Prezenca e OSBE-së mbetet e gatshme të vazhdojë mbështetjen, duke ofruar ekspertizë dhe burime për të ndihmuar Shqipërinë në përmbushjen e objektivave të saj për zhvillimin e medias. Së bashku, ne mund të sigurojmë që media në Shqipëri të mbetet një shtyllë e shoqërisë demokratike me rolin e saj të rëndësishëm në informimin dhe fuqizimin e publikut.

Ju falënderoj për vëmendjen dhe pres me padurim diskutimet tona sot për çka ju inkurajoj të angazhoheni në mënyrë aktive.